



KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIQ/OBILIC

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR, DHE PRONË

PRILL 2024



Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (PGA), në komunën e Obiliqit përkatësisht në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë (DPUKP) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), janë identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimit është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengojë gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Obiliqit me mbështetje nga AQP, ka realizuar punëtori me datat 07 Mars dhe 17 Prill 2024, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Obiliqit dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastër, Grupi II–Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DPUKP. Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

PGA në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Obiliqit në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DPUKP e Obiliqit, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
DAP	Drejtoria e Administratës Publike
KK	Kuvendi Komunal
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LK	Ligji për Kadastër
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ
ZBGJ	Zyra për Barazi Gjinore

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA OBILIQ

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Sporteli	1.1	Në sportelet e ZKK-së duhet të ketë fletëpalosje informuese për produktet dhe shërbimet kadastrale.	Printimi i fletëpalosjeve dhe udhëzuesit e ri nga AKK	AKK, ZKK dhe PGA	3,000	Q2 - 2024	Vonesa në hyrjen në fuqi të UA dhe përpilimin e Udhëzuesve të punës nga AKK
		1.2	Të vendoset një monitor në sportel	Kërkesa nga ZKK tek Drejtoria e Administratës	ZKK dhe Drejtoria e Administratës	200-300 euro	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe
2	Zyra Pritëse	2.1	Të gjendet një hapësirë për krijimin e zyrës pritëse	Të vendoset inventari i nevojshëm tek hapësira tek sporteli i ZKK-së	ZKK dhe Drejtoria e Administratës	-	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe, sfidë mund të jetë hapësira e vogël
		2.2	Të caktohet ditët për punë me palë	Vendimi nga Drejtori i ZKK-së	ZKK	-	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe, sfidë mund të jetë deri të mësohen qytetarët
3	Resurset njerëzore	3.1	Të sigurohen dy zyrtarë shtesë në Drejtori - mundësisht inxhinier (gjeodet ose arkitekt) dhe jurist	Kërkesa nga Drejtori i ZKK-së tek zyra e Kryetarit	Komuna e Obiliqit	700x12=8400euro/vit x 2	Q4 - 2024	Kërkesë e planifikuar, mund të jete rreziku tek ndikimet buxhetor
4	Mos mirëmbajtja e printerëve dhe skaner	4.1	Kërkesë në AQP përmes AKK	Shkresa nga Drejtori i ZKK-së në AKK	ZKK, AKK dhe AQP	-	Q2 - 2024	Përgjigje negative nga AQP

PJESA LIGJORE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	ZKK nuk i ka regjistruar të gjitha vendimet e shpronësimit si vërejtje në SIKTK për njësitë kadastrale të cilat përfshihen në shpronësim.	Neni 12 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (LSHPP) e detyron ZKK-në që menjëherë të shënoj vërejtjen në pronën e shpronësuar dhe neni 26 obligon ZKK-në që pronën e shpronësuar ta bartë në emër të organit shpronësues pas dorëzimit të dëshmisë së kompensimit të shpronësuarit nga organi shpronësues.	Ka filluar procesi i shënimit të vërejtjeve tek parcelat kadastrale në shpronësim	ZKK	-	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe
2	ZKK-ja, në disa raste, nuk i regjistron njësitë e reja të parcelave brenda 3 ditëve të punës pas pranimit të kërkesës për regjistrim sipas udhëzimeve të AKK-së.	Ligji i ri për Kadastër të Pronës së Paluajtshme përcakton se afati për regjistrim të njësive të reja do të jetë 15 ditë. Udhëzimi Administrativ për krijimin dhe regjistrimin e njësive të reja kadastrale është në procedurë dhe pritet të hyjë në fuqi në Prill 2024.	AKK	AKK	Nuk ka	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe

BARAZIA GJINORE DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	<p>Të shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zyrtarët komunalë të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, me fokus për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian. - Agjencia për Barazi Gjinore ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjeroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cenueshme), etj.; - Të thjeshtëzohen procedurat qe lidhen me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. 	<p>Organizimi i takimeve informuese, tryezave, fushatave vetëdijësuese me gra, burra, vajza e djem për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të organizohet fushatë informuese në rrjete sociale dhe ekraneve në shesh për sensibilizim për të drejtat e grave.</p> <p>-Agjencia për Barazi Gjinore të konsultohet me Agjencinë Kadastrale, komunat dhe OJQ-të që të zgjerojnë masën afirmative (nënat vetushqyese, gratë e veja, gratë në gjendje të cenueshme shëndetësore), dhe të bëjnë të përhershme masën afirmative.</p> <p>- Të organizohen takime me noterët dhe AKK, për të bërë ndryshime të nevojshme ligjore për thjeshtëzimin e procedurave për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.</p>	<p>Zyra për Barazi Gjinore, Kryetarët e Këshillave lokaleve, Grupet e Grave, OJQ-të. Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Noterët.</p>	<p>3,500 Euro në baza vjetore</p>	<p>Planifikimi i buxhetit për 2025 nis në Maj 2024. Të shikohen mundësitë e përfshirjes në rishikim të buxhetit për aktivitetet që planifikohen në Shtator.</p>	<p>Sfida e pjesëmarrjes së kënaqshme; mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për implementimin e aktiviteteve; ndryshimi i pushteti/mungesa e vullnetit politik.</p>
2	<p>Duhet të krijohen masa dhe të ndërmerren veprime të veçanta për mbështetjen e grave, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal, me qëllim të fuqizimit social.</p>	<p>Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja; Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të paisjeve prodhuese dhe përpunuese, në fushën e bujqësisë; subvencionimin me bagëti apo paisje në bujqësi; Të shikohen mundësitë e prioritizimit (gjatë poentimit) të aplikantëve të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve, nënat vetushqyese, gjatë ndarjes se granteve dhe subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë.</p>	<p>Planifikimi i hershëm i buxhetit në baza vjetore nga DEFZH, mbi parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Të zbatohet LBGJ dhe masat e veçanta në implementimin e ndarjes së subvencioneve në komunë. Të thjeshtëzohen procedurat dhe dokumentacionet e nevojshme për aplikim për subvencione. Të organizohen sesionet informuese për plotësimin e dokumentacionit (p.sh. përgatitja e biznes planit dhe dokumenteve përcjellëse). Të bëhet monitorimi nga komisioni komunal (të themelohet komisioni) i vazhdueshëm i përfituesve në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e projektit.</p>	<p>DEFZH, Komisioni për Subvencione Komunale, Komisione Monitoruese.</p>	<p>Të ndahet nga implementimi i Ligjit për Obiliqin, një fond komunal për mbështetjen e fondit të përhershëm ekonomik prej 150,000 Euro për vitin 2025.</p>	<p>Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 nis në Maj 2024. Të shikohen mundësitë e përfshirjes në buxhetin e vitit 2025 fondi i përhershëm komunal për fuqizim ekonomik të grave.</p>	<p>Mungesa e buxhetit dhe mungesa e konsensusit politik për këtë çështje.</p>

3	Ngritja e vetëdijes për qasjen e grave në trashëgimi.	Informata rreth legjislacionit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cenueshme. Ngritja e vetëdijes të burrave për të drejtat pronësore të grave. Sipas ligjit në fuqi, të zbatohen procedurat te noteri sa i përket marrjes së deklaratës në proceset e trashëgimisë, dhe shitblerjeve në mënyrë që gruasti sigurohet qasja e drejtë në pronë dhe trashëgimi.	Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunalë që të ndërmarrin fushata vetëdijësuese, me theks të veçantë në viset rurale dhe vendbanimet e komuniteteve. Organizimi i fushatës vetëdijësuese: Tryezë diskutimi me akterë të ndryshëm, -Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese, faqe të komunës, rrjete sociale etj. -Organizimi i takimeve informuese me qytetarët në qytet dhe vende rurale përmes përfaqësuesve të këshillave lokale. Trajnimi i vazhdueshëm me noterë për implementimin e Ligjit për Procedurën jo-kontestimore.	Zyra për Barazi Gjinore, Drejtoria për Urbanizëm, Zyra për Informim, Kryetarët e Këshillave lokale, Grupet e Grave, OJQ-të dhe Noterët.	3,500 Euro në baza vjetore	Planifikimi i buxhetit për 2025 nis në Maj 2024. Të shikohen mundësitë e përfshirjes në rishikim të buxhetit për aktivitetet që planifikohen në Shtator.	Sfida e pjesëmarrjes së kënaqshme; mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për implementimin e aktiviteteve; ndryshimi i pushteti/mungesa e vullnetit politik.
4	Të ngritet qasja e personave me nevoja të veçanta në shërbimet komunale që lidhen me pronë e kadastër.	Të sigurohet qasja për personat me të pamur të dëmtuar dhe me probleme me dëgjim. Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori.	Të sigurohet interpreti i gjuhës së shenjave dhe qasja në alfabetin e Brajlit për persona me të pamur dhe me dëgjim të dëmtuar.	Zyra e Kryetarit, Zyrja e Burimeve Njerëzore, DEFZH, Njësia Anti-diskriminim dhe Zyra për Barazi Gjinore.	5,400 Euro në vjet për interpret të gjuhës së shenjave + 5,000 për qasjen në shëbime komunale për persona me të pamur të dëmtuar.	Planifikimi i buxhetit për 2025 nis në Maj 2024. Të shikohen mundësitë e përfshirjes në buxhetin e vitit 2025 mundësia e punësimit së një personi me kontratë me afat kohor 1 vjeçar, me mundësi vazhdimi.	Mungesa e buxhetit, mungesa e stafit të kualifikuar që të punojnë në këtë fushë specifike.
5	Të shqyrtohet mundësia e lirimit nga tatimi në pronë për 50%, për periudhën 2 vjeçare kur prona regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve ose në emër të gruas.	Vendimi nga asambleja komunale për masën afirmative.	Të përgatitet propozimi për asamblenë lidhur me faljen e tatimit në pronë në vlerë 50%, për dy vitet e ardhshme për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe në emër të grave.	Kuvendi Komunal, DEFZH, Zyra e Tatimit në Pronë, ZKK, Zyrtarja për Barazi Gjinore, MAPL dhe MF.	3,000 Euro	Të përgatitet draft propozimi dhe të përfshihet në planifikimin buxhetor për vitin 2025.	Vërtetimi i ligjshmërisë me MAPL dhe MF.